



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT TË KOSOVËS
APELACIONI SUD KOSOVO – THE APPELLATE COURT OF KOSOVO

Gjykata e Apelit, bazuar në Marrëveshjes ne mes te KGJK dhe UNDP- Programi për Zhvillim te Kombeve te Bashkuara ne Prishtine, në bazë të nenit 12 par. 4 të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës si dhe në përputhje me marrëveshjen në mes të UNDP-së dhe Ministrisë së Drejtësisë:

shpall:

K O N K U R S

Nr.10/2018

1. Zyrtar Ligjor ne Gjykatën e Apelit të Kosovës.....5 (pesë) pozita

Titulli i pozitës: Zyrtar ligjor – 1
Institucioni: Gjykata e Apelit e Kosovës
Paga mujore: E përcaktuar nga donatori
Nëpunësi mbikëqyrës: Administratori

Qëllimi i pozitës:

Kryen të gjitha punët që kanë të bëjnë me shërbimet e sekretarisë, administratës, dokumentacionit si dhe shërbimet tjera juridike.

Detyrat kryesore:

- Harton akte normative si dhe aktet tjera juridike të cilat dalin nga fushë veprimtaria e institucionit në bazë të procedurave të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi.
- Kujdeset që përmbajtja dhe forma e aktit normativ të është sa më e saktë, si nga aspekti gjyqësor dhe teknik si dhe të jenë identike në të tri gjuhët zyrtare.
- Shtyp të gjitha vendimet dhe shkresat tjera të gjykatës, përgatit dhe organizon protokollin nga seancat.
- Përpilon thirrjet për dëshmitar dhe palët në seanca gjyqësore.
- Ndhmon në përpilimin e formave të nevojshme juridike.
- Bën klasifikimin dhe futjen e dosjes të korrespondencës dhe kryen detyrat tjera administrative për lëndët përkatëse.
- Siguron pjekuri të gjerë të shërbimeve të sekretarisë administrative si dhe shërbimeve tjera juridike në bazë të besimit duke pasur parasysh parimin e konfidentalitetit.
- Përgjegjës për udhëheqjen e punëve administrative të sekretarisë dhe për ofrim të punës cilësore.
- Ofron përkrahje në implementimin e Sistemit i Menaxhimit Informativ të Lëndëve(SMIL)
- Regjistron dhe kryen pune tjera në kuadër të këtij programi, sipas nevojës.

Shkathhtësitë aftësitë dhe përvoja:

1. Të ketë shkathhtësi të dëshmuara nder personale dhe komunikimi te shkëlqyeshëm me shkrim dhe me goje.
2. Të ketë shkathhtësi administrative dhe të marrjes së dokumenteve.
3. Të ketë aftësi të mira daktilografisë dhe njohja mirë e kompjuterit për përpunim të teksteve.

Kualifikimet arsimore dhe profesionale për këtë pozitë:

Diplomë universitare Fakulteti Juridik dhe një vjet punë profesionale.

Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë Qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësitë fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

Aktet ligjore dhe nënligjore që e rregullojnë rekrutimin:

Përzgjedhja bëhet në pajtim me nenin 12 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/L-149 të Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës, Ligjin Nr. 04/L-077, Për Marrëdhëniet e Detyrimeve. Në këtë konkurs zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit.

Procedurat e konkurrimit:

Procedura e konkurrimit është e hapur për kandidatët e jashtëm.

Paraqitja e kërkesave:

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve: Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë, pallati i Drejtësisë, objekti B, lagjja Prishtina e Re, rruga “Nekibe Kelmendi”, si dhe në web faqe: <http://www.gjyqesori-rks.org/>

[Shkarko Aplikacionin](#)

Për informata më të hollësishme mund ta kontaktoni : Tel. 038 200 18 445, prej orës 8:00 – 16:00.

Konkursi mbetet i hapur 3 ditë kalendarike, nga dita e publikimit, që nga data: **31.12.2018** deri më **04.01.2019** që konsiderohet dita e fundit e mbylljes së konkursit.

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda 2 ditësh; aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit për kualifikimin arsimor, përvojën e punës dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme që kërkon vendi i punës, për të cilin konkurrohet.

Aplikacionet e dorëzuara nuk kthehen!

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të ftohen në intervistë nëpërmjet telefonit.

Gjykata e Apelit e Kosovës, mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore, nga të gjitha komunitetet.